



United Nations
Nations Unies



International
Criminal Tribunal
for the former
Yugoslavia

Tribunal Pénal
International pour
l'ex-Yougoslavie

PËRMBLEDHJE E AKTGJYKIMIT TË APELIT

(Vetwm për mediat. Nuk është dokument zyrtar)

D H O M A E
A P E L I T

Hagë, 19 maj 2010

Përmbledhje e Aktgjykimit të Apelit Prokurori k. Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçulovskit

Më poshtë vijon përmbledhja e Aktgjykimit të Apelit lexuar sot prej Gjykatësit Robinson:

Sot Dhoma e Apelit është mbledhur për shpalljen e vendimit në këtë çështje.

Në bazë të praktikës së Tribunalit, unë nuk do të lexoj krejt aktgjykimin, por vetëm vendimin. Në fakt, unë do të bëj një përmbledhje të pikave të apelit dhe të konkluzioneve të Dhomës së Apelit. Përmbledhja nuk është pjesë e aktgjykimit me shkrim, i cili është dokumenti i vetëm në fuqi i arsyetimit dhe konkluzioneve të Dhomës së Apelit. Në fund të seancës palëve do t'u vihen në dispozicion kopje të aktgjykimit me shkrim

Rrethanat e përgjithshme

Kjo çështje ka të bëjë me ngjarje gjatë dhe pas një operacioni policor kryer më 12 gusht 2001 në fshatin Luboten, i cili ndodhet në pjesën veriore të ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, ndryshe IRJM. Gjatë periudhës përkatëse Lube Boshkoski ishte Ministër i Brendshëm i IRJM-së dhe Johan Tarçulovski ishte oficer policie.

Dhoma Gjyqësore e shpalli Johan Tarçulovskin fajtor për urdhërim, planifikim dhe nxitje të vrasjes, shkatërrimit pa cak dhe trajtimit mizor, të tëra shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës në bazë të Nenit 3 të Statutit. Atij iu dha një dënim i vetëm me 12 vjet burgim. Lube Boshkoski u shpall i pafajshëm në lidhje me të tëra akuzat.

Johan Tarçulovski ka parashtruar shtatë pika në apelimin e fajësimit dhe dënimin të tij. Prokuroria ka apeluar kundër shpalljes së pafajësisë së Lube Boshkoskit.

Pikat e Apelit

Fillimisht do të shqyrtoj pikat e apelit të Johan Tarçulovskit. Më tej do të shqyrtoj apelin e Prokurorisë dhe në fund të seancës do të lexoj vendimin.

Në pikën e parë të apelit të tij, Johan Tarçulovski argumenton se konflikti në IRJM gjatë periudhës përkatëse midis forcave të sigurisë të IRJM-së dhe Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare e njohur edhe si UÇK, nuk arriti në nivelin e një konflikti të armatosur meqenëse nuk përmbushi kushtin e ashpërsisë së konfliktit.

Dhoma Gjyqësore nuk gaboi në konkluzionin se niveli i ashpërsisë së konfliktit në IRJM dhe veçoritë e UÇK-së si grup i armatosur i organizuar, plotësonin kriteret e një konflikti të brendshëm të armatosur në IRJM në gusht 2001. Dhoma e Apelit nuk e gjykon të gabuar këtë konkluzion.

Më tej Johan Tarçulovski parashtron se ushtrimi i juridiksionit prej Tribunalit për këtë çështje nuk është i përshtatshëm për arsye se Tribunali nuk konkludoi në lidhje me

<http://www.icty.org>

Media Office/Communications Service

Churchillplein 1, 2517 JW The Hague. P.O. Box 13888, 2501 EW The Hague. Netherlands

Tel.: +31-70-512-8752; 512-5343; 512-5356 Fax: +31-70-512-5355

ligjshmërinë e urdhërimit prej qeverisë së IRJM-së të operacionit vetëmbrojtës për eliminimin e terroristëve në mes të fshatarëve. Për më tepër, ai argumenton se ushtrimi i juridiksionit prej Tribunalit bie ndesh me veprimet e Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Dhoma e Apelit gjykon se fakti që një shtet përdori forcën si vetëmbrojtje në një konflikt të armatosur të brendshëm, në vetvete dhe vetvetiu nuk pengon cilësimin e krimeve të kryera gjatë tij si shkelje të rënda të së drejtës humanitare ndërkombëtare. Për më tepër, Këshilli i Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara nuk deklaroi se rrethanat në IRJM ishin jashtë juridiksionit të Tribunalit.

Rrjedhimisht pika e parë e apelit të Johan Tarçulovskit hidhet poshtë tërësisht.

Në pikën e dytë të apelit, Johan Tarçulovski parashtroi se ngjarjet në Luboten më 12 gusht 2001 nuk ishin shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës, meqenëse ato ishin rezultat i përgjigjes legjitime dhe proporcionale të një shteti sovran kundër një sulmi të brendshëm terrorist. Ai gjithashtu kundërshton zbatueshmërinë e ligjeve ose zakoneve të luftës gjatë përcaktimit të përgjegjësive individuale penale të një personi të ngarkuar me kryerjen e një operacioni të ligjshëm planifikuar prej një shteti sovran.

Dhoma e Apelit gjykon se zbatimi i rregullave të vlefshme për konfliktin e armatosur nuk ka lidhje me ligjshmërinë e përdorimit të forcës prej një pale të konfliktit të armatosur. Rrjedhimisht fakti se shteti vepron në vetëmbrojtje të ligjshme kundër terroristëve në një konflikt të brendshëm të armatosur nuk e bën të pazbatueshëm Nenin e Përbashkët 3. Gjithashtu ky fakt nuk është përcaktues nëse një përfaqësuesi i këtij shteti ka kryer shkelje të rëndë të së drejtës humanitare ndërkombëtare gjatë ushtrimit të së drejtës së shtetit për vetëmbrojtje. Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore nuk gaboi në zbatimin e ligjeve ose zakoneve të luftës në këtë çështje.

Si pasojë, pika e dytë e apelit të Johan Tarçulovskit hidhet poshtë tërësisht.

Në pikën e pestë të apelit, Johan Tarçulovski argumenton se Dhoma Gjyqësore rrëzoi padrejtësisht dëshmi të kategorive të tëra dëshmitarësh megjithëse më vonë i shfrytëzoi këto dëshmi në mënyrë përzgjedhëse.

Dhoma e Apelit konstaton se Dhoma Gjyqësore i vlerësoi me kujdes dëshmitë e dhëna nga këto kategori dëshmitarësh. Johan Tarçulovski nuk ka provuar ndonjë gabim në pranimin prej Dhomës Gjyqësore të disa pjesëve të dëshmimeve të tyre dhe rrëzimin e pjesëve të tjera..

Si pasojë pika e pestë e apelit të tij hidhet poshtë.

Në pjesë të pikave 3, 4 dhe 5 të apelit të tij, Johan Tarçulovski argumenton se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se për vërtetimin e përgjegjësive penale për veprime të ndaluara në bazë të Nenit të Përbashkët 3, duhet vërtetuar vetëm se viktimat e shkeljes së pretenduar nuk merrnin pjesë aktive në luftime në kohën e kryerjes së krimit. Ai argumenton se Prokuroria gjithashtu duhet të provojë se keqbërësi ishte ose duhet të ketë qenë i vetëdijshëm për statusin e viktimës si individ i mbrojtur.

Duke marrë parasysh parimin e fajësisë individuale, Dhoma e Apelit bindet se autori i një krimi të parashikuar në Nenin e Përbashkët 3 dinte ose duhej të ketë ditur se viktimat nuk merrte pjesë aktive në luftime në kohën e kryerjes së krimit. Megjithëse në Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore nuk figurojnë konkluzione konkrete në lidhje me këtë aspekt, po të lexohet në tërësi, del qartë se Dhoma Gjyqësore shqyrtoi nëse keqbërësit e drejtpërdrejtë dinin ose duhet të kenë ditur për statusin në mbrojtje të viktimës në lidhje me çdo krim. Rrjedhimisht argumenti i Johan Tarçulovskit në lidhje me këtë pikë hidhet poshtë.

Në pikën e katërt të apelit, Johan Tarçulovski argumenton se provat ishin të pamjaftueshme për vërtetimin jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm të vrasjes, shkatërrimit pa cak dhe trajtimit mizor.

Gjithsesi Dhoma e Apelit është bindur se Dhoma Gjyqësore i identifikoi autorët e tri vrasjeve të akuzuara si individë që bënë pjesë në grupin policor të udhëhequr nga Johan Tarçulovski. Gjithashtu provat ishin të mjaftueshme për vërtetimin jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm të rrethanave të vrasjes së secilit prej viktimave si dhe statusin e viktimave dhe synimin kriminal të keqbërësve. Johan Tarçulovski nuk ka provuar se konkluzionet e Dhomës Gjyqësore në lidhje me këto aspekte ishin të gabuara.

Në lidhje me shkatërrimin pa cak të dymbëdhjetë shtëpive, Johan Tarçulovski nuk ka provuar gabime në konkluzionet e Dhomës Gjyqësore se asnjë prej shtëpive nuk mori zjarr pa dashje apo për shkak të granatimit prej ushtrisë së IRJM-së apo UÇK-së; se ishte policia ajo që iu vuri zjarrin; dhe se asnjë prej shtëpive nuk përdorej për qëllime ushtarake në kohën kur iu vu zjarri.

Rrjedhimisht pika e katërt e apelit të Johan Tarçulovskit hidhet poshtë tërësisht.

Në pikën e tretë të apelit, Johan Tarçulovski argumenton se Dhoma Gjyqësore gaboi në zbatimin e formave të përgjegjësisë së planifikimit, nxitjes dhe urdhërimit bazuar në paragrafin 1 të Nenit 7 të Statutit.

Në lidhje me planifikimin Johan Tarçulovski argumenton se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se objektivi parësor i operacionit policor në Luboten më 12 gusht 2001 ishte sulmi pa dallim kundër shqiptarëve etnikë dhe pronave të tyre. Ai pretendon se provat tregojnë se operacioni policor kishte si objektivi eliminimin e anëtarëve të UÇK-së, të përshkruar si terroristë, prej Lubotenit. Gjithashtu ai pretendon se planifikues të operacionit mund të ketë qenë Presidenti i IRJM-së ose zyrtarë të lartë të Ministrisë së Brendshme.

Dhoma e Apelit nuk e gjykon të gabuar konkluzionin e Dhomës Gjyqësore se objektivi parësor i operacionit policor në Luboten më 12 gusht 2001 ishte sulmi pa dallim kundër fshatarëve shqiptarëve dhe pronave të tyre; se Johan Tarçulovski kishte synimin e nevojshëm; dhe se ai mori pjesë në planifikimin e operacionit. Pjesëmarrja e mundshme e individëve të tjerë në planifikimin e operacionit nuk ndikon në konkluzionin e Dhomës Gjyqësore se Johan Tarçulovski ishte penalisht përgjegjës për planifikimin e sulmit.

Në lidhje me nxitjen dhe urdhërimin, Johan Tarçulovski pretendon se Dhoma Gjyqësore gaboi kur e fajësoi atë në lidhje me këto forma përgjegjësie në mungesë të provave se ai kishte nxitur apo udhëzuar individë të tjerë në kryerje krimesh. Gjithashtu në lidhje me urdhërimin ai pretendon se nuk kishte prova se ai kishte pushtet *de jure* ose *de facto* për urdhërimin e vrasjeve, djegieve ose rrahjeve. Më tej ai parashtroi se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se ai kishte synimin kriminal për urdhërimin e kryerjes së krimeve konkrete, megjithëse nuk mundi të identifikojë urdhëruesin e operacionit.

Dhoma e Apelit nuk e gjykon të gabuar konkluzionin e Dhomës Gjyqësore se Johan Tarçulovski nxiti dhe udhëzoi policë për kryerjen e krimeve në fjalë dhe se ai gëzonte pushtet për t'i detyruar që të kryenin krime. Fakti se ai u urdhërua të udhëhiqte operacionin nuk e shfajëson prej përgjegjësisë penale në qoftë se gjatë zbatimit të urdhrit ai nga ana e tij udhëzoi persona të tjerë që të kryenin krim.

Për rrjedhojë pika e tretë e apelit të Johan Tarçulovskit hidhet poshtë tërësisht.

Pika e gjashtë e apelit të Johan Tarçulovskit ka lidhje me deklaratat e tij dhënë një komisioni të ngritur prej Ministrisë së Brendshme për hetimin e ngjarjeve në Luboten. Ai pretendon se këto deklarata jashtëgjyqësore u pranuan si prova në mënyrë të papërshtatshme, ose përndryshe u përdorën në mënyrë të papërshtatshme.

Dhoma e Apelit gjykon se Dhoma Gjyqësore duke u bazuar në Rregullën 89 të Rregullores së Procedurës dhe Provave kishte të drejtë t'i pranonte deklaratat si pasqyrim i saktë i dëshmisë së Johan Tarçulovskit për komisionin. Parimet e përgjithshme të së drejtës nuk i përjashtojnë deklaratat jashtëgjyqësore. Për më tepër, Tribunali nuk kushtëzohet prej rregulloreve të provave të shteteve. Dhoma e Apelit gjithashtu konkludon se Dhoma Gjyqësore i peshoi me kujdes deklaratat duke marrë parasysh edhe provat e tjera.

Si pasojë pika e gjashtë e apelit të Johan Tarçulovskit hidhet poshtë.

Në pikën e shtatë të apelit të tij, Johan Tarçulovski deklaroi se Dhoma Gjyqësore gaboi kur e dënoi me dymbëdhjetë vjet burgim. Konkretisht, ai argumenton se Dhoma Gjyqësore nuk mori parasysh si rrethanë lehtësuese faktin se ai zbatonte urdhra të individëve më të pushtetshëm. Gjithashtu ai parashtron se Dhoma Gjyqësore nuk mori parasysh se më vonë IRJM-ja i amnistoi pjesëmarrësit e të dy palëve në konflikt.

Dhoma e Apelit gjykon se gjatë vlerësimit të peshës së shkeljeve, Dhoma Gjyqësore në fakt mori parasysh se Johan Tarçulovski zbatonte urdhra të individëve të panjohur. Gjithashtu legjislacioni përkatës i IRJM-së përmban një dispozitë ku sanksionohet se invididët përgjegjës për kryerjen e veprave penale brenda juridiksionit të Tribunalit përjashtohen prej amnistisë. Për më tepër Dhoma Gjyqësore nuk kushtëzohet prej praktikës së dënimeve në IRJM.

Rrjedhimisht pika e shtatë e apelit të Johan Tarçulovskit hidhet tërësisht poshtë.

Tani i vjen radha apelit të Prokurorisë kundër dhënies së pafajësisë Lube Boshkoskit.

Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore bëri gabim ligjor kur bazuar në paragrafin 3 të Nenit 7 të Statutit, kushtëzoi pasaktësisht se mjafton vetëm që eprori t'u raportojë autoriteteve kompetente, që me gjasë do të çonte në një hetim të pretendimit për veprime kriminale.

Mirëpo Dhoma e Apelit është bindur se Dhoma Gjyqësore me të drejtë konkludoi se në rrethana të caktuara eprori mund t'i përmbushë detyrimet e tij për ndëshkimin e një vartësi shkelës nëpërmjet raportimit te autoritetet kompetente me kusht që të ketë të ngjarë që raportimi të çojë në hetim ose procedim disiplinor ose penal.

Përndryshe Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore bëri gabim faktual kur konkludoi se Lube Boshkoski kishte marrë masa të nevojshme dhe të arsyeshme për ndëshkimin e vartësve shkelës. Konkretisht Prokuroria argumenton se raportet e paraqitura autoriteteve gjyqësore kompetente nga Ministria e Brendshme nuk ishin të mjaftueshme për nisjen e një hetimi penal për ngjarjet në Luboten.

Dhoma e Apelit konstaton se Dhoma Gjyqësore ishte në dijeni se njoftimet e dhëna instancave gjyqësore nga Ministria e Brendshme nuk ishin plotësisht të mjaftueshme. Dhoma Gjyqësore gjithashtu pranoi se nuk ishte kryer asnjë hetim policor i zakonshëm në lidhje me ngjarjet përkatëse. Mirëpo Dhoma Gjyqësore konkludoi se normalisht njoftimet duhej t'i kishin shtyrë autoritetet gjyqësore për kryerjen e një hetimi të përshtatshëm.

Gjatë nxjerrjes së këtij konkluzioni, Dhoma Gjyqësore konstatoi veçanërisht se njoftimet sollën në vëmendjen e autoriteteve kompetente vdekjen e shqiptarëve etnikë dhe megjithëse sugjeruan shkakun e vdekjes, e lanë atë të hapur. Gjithashtu provat tregojnë se më 12 dhe 14 gusht 2001 u bënë njoftime dhe se autoritetet kompetente ngritën menjëherë një ekip hetimor i cili u përpoq të kryente një hetim në terren në Luboten. Po ashtu provat tregojnë se Lube Boshkoski u informua për njoftimet dhe përpjekjet hetimore. Dhoma Gjyqësore konkludoi se dështimi i rëndë për një kryerje të përshtatshme të hetimit bazuar në raportet policore për autoritetet gjyqësore nuk mund t'i ngarkohej Lube Boshkoskit sepse autoritetet gjyqësore nuk ishin nën pushtetin e tij ministror. Dhoma Gjyqësore gjithashtu konkludoi se nuk kishte bazë për konkluzionin se ai u orvat të ndërhynte në

mënyrë të palejueshme në hetime ose se ishte në dijeni të moskryerjes së detyrave normale prej policisë. Prokuroria nuk ka provuar se këto konkluzione ishin të gabuara.

Dhoma e Apelit konkludon se Dhoma Gjyqësore nuk gaboi kur konkludoi se normalisht njoftimet duhej t'i kishin shtyrë autoritetet gjyqësore në kryerjen e një hetimi të përshtatshëm të ngjarjeve në Luboten. Bazuar në këtë konkluzion, Dhoma Gjyqësore konkludoi se nuk ishte provuar se Lube Boshkoski nuk mori masa të nevojshme dhe të arsyeshme. Në rrethanat e kësaj çështjeje ishte e mundshme për një gjykes të arsyeshëm faktesh që ta lironte Lube Boskoskin prej përgjegjësisë së ndëshkimit bazuar në informacionin e dhënë autoriteteve gjyqësore. Dhoma Gjyqësore nuk bëri gabim faktual në nxjerrjen e këtij konkluzion.

Si rezultat apeli i Prokurorisë hidhet poshtë tërësisht

Vendim

Tani do të lexoj vendimin e Aktgjykimit të Apelit. Z. Boshkoski dhe Z. Tarçulovski, ju lutem ngrihuni.

Për arsyet e lartpërmendura, DHOMA E APELIT,

BAZUAR NË Nenin 25 të Statutit dhe Rregullat 117 dhe 118 të Rregullores së Procedurës dhe Provave;

DUKE MARRË PARASYSH parashtrimet përkatëse me shkrim të Palëve dhe argumentet e paraqitura prej tyre në seancën e 29 tetorit 2009;

E MBLEDHUR në sesion të hapur;

HEDH POSHTË tërësisht apelin e Johan Tarçulovskit;

HEDH POSHTË tërësisht apelin e Prokurorisë;

LË NË FUQI verdiktin e pafajësisë së Lube Boshkoskit dhe dënimin e Dhomës Gjyqësore kundër Johan Tarçulovskit, duke llogaritur periudhën e kaluar në paraburgim prej Johan Tarçulovskit bazuar në paragrafin C të Rregullës 101 të Rregullores; dhe

URDHËRON në përputhje me paragrafin C të Rregullës 103 dhe Rregullën 107 të Rregullores, që Johan Tarçulovski të mbahet në paraburgim prej Tribunalit deri në organizimin e masave për transferimin e tij në shtetin ku do të vuajë dënimin.

Bashkëngjitur mendimi i veçantë i Gjykatësit Liu.
